# KODI I ETIKËS

I

# UNIVERSITETIT TË SHKODRËS

# *«LUIGJ GURAKUQI»*

Universiteti i Shkodrës
"Luigj Gurakuqi"



# Kodi i Etikës

Shkodër, tetor 2009

- REPUBLIKA E SHQIPERISË -
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI"
SHKODËR

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

### Objekti dhe qëllimi

1. Ky Kod është hartuar në zbatim të nenit 17 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 *"Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë"* (i ndryshuar), të nenit 17 të Statutit të Universitetit të Shkodrës *"Luigj Gurakuqi"* dhe të gjithë legjislacionit tjetër në fuqi për arsimin e lartë.
2. Kodi i Etikës është një tërësi rregullash dhe parimesh etike që përcakton standardet e sjelljes së punonjësve akademikë, administrativë dhe të studentëve të Universitetit të Shkodrës *"Luigj Gurakuqi"*.
3. Kodi i Etikës së USH-së siguron bazën ligjore dhe morale mbi të cilën veprojnë të gjithë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

### Neni 2

### Fusha e veprimit

1. Dispozitat e këtij Kodi janë të detyrueshme njësoj nga të gjitha subjektet e Kodit të Etikës të USH-së.
2. Dispozitat e këtij Kodi përbëjnë detyrim edhe për personat e tretë që hyjnë në marrëdhënie me USH-në.

## Neni 3

## Subjektet

1. Subjekte të Kodit të Etikës në USH janë stafi akademik, ai ndihmës mësimor, ai administrativ dhe studentët e USH-së.
2. Çdo subjekt është i detyruar të njohë dhe të respektojë këtë Kod.

## Neni 4

## Parime të përgjithshme

1. Kodi i Etikës i USH-së ka në themel parimet e parashikuara në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin për Arsimin e Lartë, në kodin e punës dhe në Statutin e USH-së.
2. Në përmbushje të detyrave subjektet e Kodit të Etikës duhet të respektojnë këto parime :

*a. Respektimi i ligjit*

Subjektet e Kodit të Etikës janë të detyruar të respektojnë të gjitha aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

*b. Objektiviteti*

Të gjithë anëtarët e stafit akdemik, ndihmës-mësimor dhe administrativ duhet të veprojnë me objektivitet dhe mbi baza të paanshmërisë, pa preferenca e favorizime të individëve të caktuar.

*...erat individuale morale*

Subjektet e Kodit të Etikës janë të detyruar të eleminojnë në jetën e tyre private sjelljet që kanë ndikim negativ në imazhin në shoqëri ose që lëkundin besimin e komunitetit ndaj USH-së.

*...ësjellja*

Të gjitha subjektet e Kodit të Etikës në USH në marrëdhëniet e ndërsjellta ndërmjet tyre janë të



*e. Integriteti*

Të gjithë punonjësit e USH-së nuk duhet ta vënë veten e tyre nën ndonjë detyrim financiar apo çdo lloj tjetër detyrimi kundrejt individëve apo organizatave të ndryshme të komunitetit, që mund të ushtrojnë ndikim ndaj tyre gjatë zbatimit të funksioneve të tyre.

*f. Transparenca*

Çdo drejtues i strukturave universitare dhe çdo punonjës akademik e administrativ i USH-së, ka për detyrë t'u bëjë të ditur të gjithë studentëve dhe të gjithë të interesuarve shërbimet që ofron USH.

*g. Ndershmëria*

Të gjithë punonjësit e USH-së gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre duhet të karakterizohen nga ndershmëria dhe korrektesa.

*h. Efektiviteti*

Punonjësit akademikë, ata ndihmës-mësimorë dhe administrativë shfrytëzojnë të gjitha aftësitë e tyre për kryerjen e detyrave dhe e përdorin kohën e punës vetëm për kryerjen e këtyre detyrave.

*i. Përgjegjshmëria*

Çdo subjekt i Kodit të Etikës është përgjegjës për veprimet që kryen. Secili punonjës i USH-së ka përgjegjësi për vendimet që merr dhe për arritjen e rezultateve në punë.

*j. Dhuratat apo favoret*

Punonjësit akademikë, ata ndihmës-mësimorë dhe administrativë të USH-së nuk duhet të kërkojnë apo pranojnë nga askush dhurata, shërbime, shpërblime në vlerë monetare në favor të tyre për zbatimin e detyrës funksionale.

*k. Konfidencialiteti*

Punonjësit akademikë, ata ndihmës-mësimorë dhe

detyruar të zbatojnë parimet dhe rregullat e mirësjelljes.

*e. Integriteti*

Të gjithë punonjësit e USH-së nuk duhet ta vënë veten e tyre nën ndonjë detyrim financiar apo çdo lloj tjetër detyrimi kundrejt individëve apo organizatave të ndryshme të komunitetit, që mund të ushtrojnë ndikim ndaj tyre gjatë zbatimit të funksioneve të tyre.

*f. Transparenca*

Çdo drejtues i strukturave universitare dhe çdo punonjës akademik e administrativ i USH-së, ka për detyrë t'u bëjë të ditur të gjithë studentëve dhe të gjithë të interesuarve shërbimet që ofron USH.

*g. Ndershmëria*

Të gjithë punonjësit e USH-së gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre duhet të karakterizohen nga ndershmëria dhe korrektesa.

*h. Efektiviteti*

Punonjësit akademikë, ata ndihmës-mësimorë dhe administrativë shfrytëzojnë të gjitha aftësitë e tyre për kryerjen e detyrave dhe e përdorin kohën e punës vetëm për kryerjen e këtyre detyrave.

*i. Përgjegjshmëria*

Çdo subjekt i Kodit të Etikës është përgjegjës për veprimet që kryen. Secili punonjës i USH-së ka përgjegjësi për vendimet që merr dhe për arritjen e rezultateve në punë.

*j. Dhuratat apo favoret*

Punonjësit akademikë, ata ndihmës-mësimorë dhe administrativë të USH-së nuk duhet të kërkojnë apo pranojnë nga askush dhurata, shërbime, shpërblime në vlerë monetare në favor të tyre për zbatimin e detyrës funksionale.

*K. Konfidencialiteti*

Punonjësit akademikë, ata ndihmës-mësimorë dhe



mbështetje të Ligjit nr. 9887, datë 10. 03. 2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" (por pa cënuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 8503 datë 30. 06. 1999 "*Për të drejtën e informimit*"), të ruajnë konfidencialitetin e informacionit që kanë në zotërim.

**Neni 5**

**Këshilli i Etikës**

1. Këshilli i Etikës është organ kolegjial pranë USH-së, që trajton probleme që lidhen me etikën, me shkelje të saj dhe sjellje të parashikuara nga ky Kod.
2. Këshilli i Etikës përbëhet nga 5 anëtarë dhe kryesohet nga Rektori.
3. Në përbërje të Këshillit ka edhe një anëtar jurist.
4. Një anëtar i Këshillit të Etikës zgjidhet sekretar i këshillit dhe ka për detyrë, veç të tjerash, të mbajë protokollin e mbledhjes.
5. Materialet e shkruara janë konfidenciale dhe ruhen. Çdo procedurë e Këshillit arkivohet.

**Neni 6**

**Monitorimi**

1. Këshilli i Etikës është përgjegjës për njohjen, monitorimin dhe zbatimin korrekt të Kodit të Etikës.

**Neni 7**

**Vendimet e Këshillit**

1. Këshilli i Etikës në shqyrtimin e kërkesave dhe të ankesave shprehet me vendim.
2. Këshilli i Etikës i merr vendimet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve.
3. Vendimet e Këshillit janë përfundimtare dhe nuk mund të ankimohen.

## Neni 8

## Shkelje të rregullave të etikës

1. Shkelje të rregullave të etikës konsiderohen :
   a. mungesa e respektit, e mirësjelljes, e konsideratës dhe e profesionalizmit ndërmjet subjekteve të Kodit të Etikës
   b. diskriminimi bazuar në dallimin racial. besimin, ngjyrën. kombësinë, etninë, seksin, orientimin seksual. privatësinë, invaliditetin, fenë, gjendjen civile apo çdo lloj çështjeje që mbrohet me ligj
   c. ofrimi, kërkimi, dhënia ose pranimi i çfarëdo lloj dhurate apo përfitimi tjetër për veten, familjen, të afërmit, nga persona apo organizata me të cilat ka marrëdhënie dhe që ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës
   d. marrja e paautorizuar e dokumenteve dhe publikimi i të dhënave personale jashtë kritereve ligjore
   e. veshja dhe paraqitja jokorrekte dhe joestetike në ambjentet e USH-së
   shpërndarja apo konsumimi i pijeve alkolike, duhanit dhe substancave narkotike në ambientet e USH-së
   veprimet joprofesionale e të pasjellshme. vërejtjet përçmuese. fyerjet, shpifjet apo ngacmimet fizike dhe morale
   deklarimet. shkrimet apo publikimet që dëmtojnë a



denigrojnë imazhin e USH-së;
   i. përdorimi abuziv dhe jashtë funksioneve zyrtare i materialeve.i burimeve dhe i ambienteve të USH-së (auditoret, bibliotekat, laboratoret, palestra, zyrat etj.)
   j. përdorimi i emrit të USH-së në botime, promovime apo reklama pa miratim nga titullari
   k. prishja e qetësisë në ambientet e USH-së
   l. kopjimi, dhënia apo marrja e ndihmës nëpërmjet përdorimit të materialeve të shkruara ose formave të tjera gjatë provimit
   m. padité apo deklaratat e pabaza me keqbesim a për arsye irrituese ndaj subjekteve të Kodit të Etikës
   n. Përvetësimi i studimeve të të tjerëve. plagjiaturat apo format e tjera të vjedhjes intelektuale

## Neni 9

## Procedura për trajtimin e shkeljeve

1. Çdo shkelje i raportohet Këshillit të Etikës mbi bazën e një kërkese apo ankese me shkrim.
2. Çdo subjekt i Kodit të Etikës që konstaton një shkelje raporton me anë të një shkrese me shkrim direkt te sekretari i këshillit, i cili ka detyrimin të caktojë brenda 10 ditëve mbledhjen e anëtarëve për shqyrtimin e shkeljes.

## Neni 10

## Masat disiplinore

1. Këshilli i Etikës, në varësi të shkeljes. intensitetit të saj, rëndësisë, recidivitetit dhe pasojës që ka sjellë për USH-në apo për subjektet e Kodit të Etikës, mund të marrë këto masa:
   a. **për personelin akademik**, atë **ndihmës mësimor** dhe atë **administrativ**:

- vërejtje me shkrim,
- vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra,
- pezullim për një afat një mujor deri në 3 muaj.
- kalimin nga një detyrë në një tjetër,
- largim përfundimtar nga Universiteti.

b. **për studentët:**
- vërejtje me shkrim,
- vërejtje me paralajmërim,
- pezullim nga një semestër deri në një vit akademik,
- heqja e së drejtës së studimit.

2. Caktimi i masave displinore parimisht bëhet në mënyrë progresive.
3. Nuk do të ndiqet rregulli i mësipërm në rastet e shkeljeve të rënda.

**Neni 11**

**Dispozitat e fundit**

1. Ky Kod mund të ndryshohet apo plotësohet me kërkesë të titullarit të institucionit ose me kërkesë të 13 anëtarëve të Senatit Akademik të USH-së.
2. Për shkelje të tjera të etikës të paparashikuara, por të konstatuara, Këshilli i Etikës mund të vendosë në përputhje me parimet e përgjithshme morale dhe ligjet në fuqi.
3. Ky kod hyn në fuqi 30 ditë nga miratimi në Senatin Akademik dhe me shpalljen e tij nga Rektori i USH-së.

**Kryetari i Senatit**

**Prof. Dr. Artan HAXHI**

***Shkodër, më 11.11.2009***

Universiteti i Shkodrës
"Luigj Gurakuqi"

- REPUBLIKA E SHQIPËRISË -
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI"
SHKODËR